

VENDIM
Nr. 658, datë 6.12.2023

**PËR AUTORIZIMIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT PËR NEGOCIMIN DHE
NËNSHKRIMIN E RINOVIMIT TË MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT
STRATEGJIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “MICROSOFT CORPORATION”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 31, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për negocimin dhe nënshkrimin e rinovimit të marrëveshjes së partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “*Microsoft Corporation*”.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku